

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Nebojsha Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit M.Gj., nga fshati T., komuna e I., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.2 dhe 1.8 të KPK, duke vendosur përkritazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR Pejë P.nr.30/2017 datë 31.03.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - DKR, PAKR.nr.307/2017 datë 20.07.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16 janar 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit Mustafë Gjocaj, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR Pejë P.nr.30/2017 datë 31.03.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - DKR, PAKR.nr.307/2017 datë 20.07.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - DKR Pejë P.nr.30/2017 datë 31.03.2017, i dënuari M.Gj., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.2 dhe 1.8 të KPK, dhe për këtë vepër është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj dhe me dënim me gjobë në shumë prej 1000 €. Dënimin me gjobë është i obliguar që të paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nëse gjoba nuk ekzekutohet apo i dënuari refuzon ekzekutimin, do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur 1 ditë burgu me 20 €. Është shqiptuar edhe dënimi

plotësues konfiskimi i narkotikut të llojit marihuanë në peshë prej 51.80 gr. Është detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 100 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 25 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin e saj PAKR.nr.307/2017 datë 20.07.2017, e ka refuzuar ankesën e Prokurorit të Shtetit ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar, kurse sipas pikës 2 ankesën e mbrojtësit të të dënuarit e ka hedh si të palejuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit M.Gj., A.D., avokat nga M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, ose të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.223/2017 datë 30.11.2017, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që e njëjta të hidhet si e pasafatshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit potencon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse është shkelur dispozita e nenit 248 par.1 pika 3 të KPPK-Instituti i pranimi të fajësisë për faktin se pranimi i fajësisë nuk gjen mbështetje në provat në të cilat mbështetet akuza dhe kështu gjyqtari është dashur që të mos pranojë pranimin e fajësisë dhe të veprojë konform paragrafit 3 të kësaj dispozite.

Po ashtu, theksohet se në aktgjykimin e shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare lidhur me dënimin e shqiptuar ashtu që përkundër faktit se gjykatat nuk gjejnë rrethana posaçërisht lehtësuese i kanë shqiptuar dënimin në pajtim me nenin 75 të KPK nën minimumin e paraparë ligjor. Më pas mbrojtësi citon dispozitën e lartë cekur për të theksuar se në rastin konkret mungojnë arsyet lidhur me këto rrethanat.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimet e sipër përmendura nuk janë të bazuara nga këto arsye:

Siç rezulton nga shkresat e çështjes i dënuari M.Gj., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.2 dhe 1.8 të KPK, sepse me 18.01.2017, rreth orës 12,40 në Qendrën Korrektuese-Dubravë, Komuna e Istogut në cilësinë e personit zyrtar-mësimdhënës me qëllim të shitjes apo të shpërndarjes brenda institucionit korrektues ka poseduar narkotik të llojit mariuhanë në peshë prej 51.80 gr. dhe në momentin kur është dashur të futet në portën e re, është ndaluar nga oficerët korrektues të burgut me ç ‘rast gjatë kontrollit tek organet gjentiale të tij është zbuluar dhe sekuestruar narkotiku në fjalë.

Nga aktgjykimet e kundërshtuara, dhe procesverbali mbi shqyrtimin gjyqësor i datës 31.03.2017, rezulton se i dënuari M.Gj., ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë. Nga i njëjti procesverbal rezulton se i dënuari pas konsultimeve të bëra me mbrojtësin e tij avokatin M.H., ka pranuar fajësinë dhe në këtë rast mbrojtësi jo vetëm që ka marrë pjesë aktive rreth deklaramit të dënuarit për fajësinë ka deklaruar "mbrojtja konsideron se pranimi i fajësisë e ka mbështetje ne provat e paraqitura në aktakuzë andaj, kërkohmë nga gjykata që ta pranojë pranimin e fajësisë...". Me këtë rast i dënuari e as mbrojtësi i tij, nuk kanë kundërshtuar përshkrimin faktik të veprës penale e as cilësimin juridik, si dhe provat në të cilat është mbështetur akuza. Për këtë arsye gjykata e shkallës së parë ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore nga dispozita e nenit 248 të KPPK, siç është konstatuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, prandaj gjykata nuk ka administruar prova, por shqyrtimin ka vazhduar me fjalën përfundimtare dhe shqiptimin e dënimit.

Nuk është i bazuar pretendimi se në rastin konkret është shkelur parimi i pranimit të fajësisë, meqë siç edhe u cek më lartë pranimi i fajësisë është bërë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe ky pranim mbështetet edhe në provat tjera të ofruara nga Prokurori i Shtetit, në radhë të parë në ekspertizën e narkotikut të ekzaminuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë datë 09.03.2017 nga e cila rezulton se këtu kemi të bëjmë me lëndën narkotike të llojit marihuanë, e një gjë të tillë dënuari e as mbrojtësi i tij nuk e kanë kontestuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe konkret në të, duke pasur parasysh se i njëjti është marrë mbi bazën e pranimit të fajësisë, në të janë dhënë arsye të duhura juridike lidhur me shqiptimin e dënimit, respektivisht me këtë rast gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me matjen e dënimit. Kështu në arsyetim qëndron konstatimi "...rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, ndërsa si rrethana lehtësuese janë marrë sjellja e të akuzuarit para dhe pas kryerjes se veprës penale, se më parë nuk ka kryer ndonjë vepër penale, gjendja e dobët ekonomike, se është mbajtës i familjes, e posaçërisht fakti se i akuzuari që në fillim të shqyrtimit gjyqësor në tërësi e ka pranuar veprën penale për të cilën është akuzuar." dhe kështu gjykata i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj,

(dënimi i paraparë për këtë vepër penale është 3 deri në 15 vjet), të cilin e ka konfirmuar edhe gjykata e shkallës së dytë. Prandaj, nga arsyetimi del dhe është e qartë, se gjykata e shkallës së parë si rrethanë veçanërisht lehtësuese, ka vlerësuar pranimin e fajësisë. Vlen të theksohet se lidhur me të njëjtin pretendim të paraqitur në ankesën e Prokurorit të shtetit, gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye në faqen 2 të aktgjykimit, të cilin si të drejtë e pranon edhe kjo gjykatë.

Nga arsyet e dhëna më sipër, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe konform dispozitës së nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
PML.nr.326/2017 datë 16 janar 2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta